



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni i Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

Dokument Parlamentar

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .2019

RAPORT

**PËR MIRATIMIN E NUMRIT TE PUNONJESVE
PËR KLGJ DHE KLP PER VITIN 2019**

Komisioni i Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, në datën 19 Shkurt 2019, sipas rendit të ditës, mori në shqyrtim kërkesat për buxhet dhe staf të përcjella Kuvendit të Shqipërisë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshili i Lartë i Prokurorisë.

Relator i çështjes u caktua Deputeti Bashkim Fino.

Me shkresën e datës 24.01.2019, Zonja Naureda Llagami, i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë Vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, një relacion bashkëlidhur vendimit, strukturën si dhe aneksin me parashikimin Buxhetor në mbështetje të skemës.

Me shkresën e datës 25.01.2019, Zoti Genti Ibrahim, i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë Vendimin nr. 17, datë 21.01.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e Strukturës organizative, numrit të punonjësve dhe buxhetin për Vitin 2019”, bashkëlidhur vendimi i KLP si dhe struktura organizative.

Praktikat u ishin dërguar më parë për opinion dhe konsultim edhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave si dhe Departamentit të Administratës Publike.

Neni 79, pika 2 dhe 178, pika 2 parashikojnë shprehimisht se janë përkatësisht KLGJ dhe KLP që vendosin për strukturën e administratës dhe të secilës njësi. Kjo për arsye se organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, janë pjesë e një pushteti të pavarur që do të thotë se gëzon

pavarësi funksionale, organizative dhe financiare. **(Neni 2 i Ligjit: “Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efikasitë”)**).

Komisioni shqyrtoi kërkesat e të dy Këshillave, për arsye se Ligji për Buxhetin e Shtetit për Vitin 2019, si rast përjashtimor ka parashikuar miratim më vete të mbështetjes buxhetore për organet e reja të administrimit të sistemit të drejtësisë, ku hyjnë dhe KLGJ dhe KLP të cilët priteshin të ngriheshin gjatë vitit 2019.

Komisioni për të analizuar nevojat e institucioneve për staf, arsyetoi mbi:

- kompetencat që ushtrojnë këto organe të sistemit të drejtësisë, të cilat janë të ngjashme, por ndahen vetëm në funksion të trupave që mbikqyrin dhe për të cilat marrin vendime;
- shifrat duke i krahasuar ato me numrin e trupave të drejtësisë që duhet të mbikqyren dhe rregullohen prej organeve të reja të drejtësisë.

Komisioni konstatoi se për KLGJ, neni 70 i ligjit 115/2016, vë disa piketa për organizimin e administratës së KLGJ, duke parashikuar që brenda strukturës organizative duhet të që të ketë:

- 1- njësi mbështetëse për çështjet juridike;
- 2- njësi mbështetëse pranë secilit komision të përhershëm të Këshillit;
- 3- njësi mbështetëse për hartimin e buxhetit të këshillit dhe buxhetit gjyqësor;
- 4- zyra e këshilltarit të etikës;
- 5- njësi mbështetëse për marrdhëniet me publikun dhe botimet;
- 6- njësi mbështetëse për trajnimin e gjyqtarëve dhe
- 7- njësi mbështetëse për IT.

Për të dyja strukturat, duke i krahasuar me njera-tjetrën, u vu re se pjesa e strukturave të vendimmarrjes institucionale që janë mbi Sekretarin e Përgjithshëm, si në KLP edhe në KLGJ, janë të ngjashme dhe të për’afërta edhe në numer personash (18 KLP dhe 19 KLGJ);

Për sa i takon analizës së nevojave për mbështetje buxhetore, referuar ligjit të Buxhetit Vjetor, në buxhetin e miratuar me Ligjin e Buxhetit për Vitin 2019 rezulton se Fondi total i rezervuar për institucionet e reja të sistemit të drejtësisë është 400 milionë.

Për sa i takon kompetencës së Kuvendit për të miratuar numrin e punonjësve për vitin 2019, Komisioni i referon Kuvendit se:

Ligji për Buxhetin e Shtetit për Vitin 2019, si rast përjashtimor ka parashikuar miratim më vete të mbështetjes buxhetore për organet e reja të administrimit të sistemit të drejtësisë, të cilat priteshin të ngriheshin gjatë vitit 2019.

Për këtë Ligji i Buxhetit për Vitin 2019 ka parashikuar:

Neni 11 - Rishpërndarja e numrit të punonjësve të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe e numrit rezervë të tyre, bëhet nga Këshilli i Ministrave, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.

Neni 13- Fondi deri në 400 milione është lënë si fond rezerve për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.

Duke iu referuar Ligjit të Buxhetit 2019, (nr.99, datë 3.12.2018), neni 10, 11 dhe neni 13, roli i Kuvendit ka të bëjë me përcaktimin e numrit të përgjithshëm të strukturës së KLGJ dhe KLP për vitin 2019, pasi duhet prekur fondi rezervë parashikuar për ngritjen e organeve të reja të Drejtësisë.

Kuvendi në miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të të dy Këshillave, merr në analizë nevojat për burime njerëzore, investime, shpensime etj. që kërkohen prej tyre në raport me mundësitë buxhetore dhe financimin e zërave për mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë.

Komisioni në mbështetje të arsytimit më sipër mund të argumentojë dhe propozojë numrin e stafit për secilin prej organeve të reja të qeverisjes së Drejtësisë, në rastin konkret KLGJ dhe KLP, por e ka të pamundur të bëjë llogaritjet për sa i takon mbështetjes Buxhetore, për shkak se llogaritja e nevojave për buxhet duhet të bëhet më pas, pasi vetë organet të kenë reflektuar në strukturë numrin e stafit që do të miratohet nga Kuvendi.

Nga analiza dhe konsultimi i kryer me Ministrinë e Financave dhe DAP, rezulton se mundësia për financim të nevojave që kërkojnë të dy Këshillat është 125 për KLGJ dhe 65 për KLP. Komisioni gjykoi se ky numër i përshtatet nevojave për fillimin e punës dhe gjatë vitit në varësi të kërkesave të reja të dy këshillave për plotësime në numër punonjësish, Kuvendi mund ta rivlerësojë këtë çështje. Kjo dhe për faktin se po ky Komision është përgjegjës për përcaktimin e numrit të punonjësve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Byrosë Kombëtare të Hetimit SPAK dhe Gjykatës së Posaçme anti-Korrupsion. Pas akomodimit të nevojave të të gjithë institucioneve, numri i punonjësve tek të dy Këshillat mund edhe të rishikohet në raport me nevojat që hasen gjatë ushtrimit të kompetencave.

Në këto kushte Komisioni i propozon Kuvendit, që ti delegojë Këshillit të Ministrave, analizën, shqyrtimin dhe miratimin e fondit, në përputhje me numrin e punonjësve të miratuar nga Kuvendi dhe strukturës së miratuar nga vetë organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë.

Në përfundim të diskutimeve dhe pas konsultimit edhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni i Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, me votën pro të të gjithë deputetëve prezentë, miratoi numrin e punonjësve për KLGJ - 125 dhe për KLP - 65.

Bashkëlidhur këtij Raporti janë projekt-vendimet e Kuvendit për miratimin e numrit të punonjësve për vitin 2019, për KLGJ dhe KLP.

Propozimi i përcillet për miratim Kuvendit.

Relator
Bashkim FINO

Kryetar
Ulsi MANJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. ____/2019

**PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË
KËSHILLIT TË LARTË TË GJYQËSOR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 11 dhe 13 të ligjit nr. 99/2018, “Për Buxhetin e Vitit 2019”,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

- I. Miratimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Lartë Gjyqësor 125.
- II. Fondi për krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Gramoz RUÇI

Miratuar në datën ____ .2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. ____/2019

**PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 11 dhe 13 të ligjit nr. 99/2018, “Për Buxhetin e Vitit 2019”,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

- IV. Miratimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë 65.
- V. Fondi për krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Gramoz RUÇI

Miratuar në datën ____ .2019